



Prishtinë, 23, dhjetor 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_874\_2016

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 15 dhe nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos sh.a. të datës 8 dhjetor 2016, për miratimin e dokumentit: Bilanci Afatgjatë të Energjisë Termike.

Pas shqyrtimit të dokumentit në fjalë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 23 dhjetor 2016, nxori këtë:

## VENDIM

- I. **APROVOHET BILANCI AFATGJATË I ENERGISË TERMIKE për periudhën 2017 - 2026 i NQ Termokos sh.a.**

### Arsyetim

1. Me datë 9 dhjetor 2016, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar draftin final të dokumentit: Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike për periudhën 2017-2026 nga NQ Termokos sh.a. si bartës i Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike.
2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike" të dorëzuar nga NQ Termokos dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi menjëherë të publikojë dokumentin "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2017-2026" në faqen elektronike zyrtare të tij.
- III. Duke pasur parasysh ndikimin e parametrave të ndryshëm të bilancit në përcaktimin e tarifave, ZRRE mban të drejtën që gjatë shqyrtimeve tarifore të përshtatë të dhënat që përmban Bilanci afatgjatë i energjisë termike.
- IV. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të monitoroj implementimin e Bilancit Afatgjatë të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në këtë Bilanc.



V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.

VII. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku gjithashtu do të publikohet edhe Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2017-2026

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, U.D. Kryesues

Arsim Janova, Anëtar

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike – 2017-2026, NQ Termokos

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së